


KLSH merr pjesë në takimin me temë “ClimateScanner, Last Call” (në shqip: “Skaneri i klimës, Thirrja e fundit”), organizuar nga SAI Brazil (TCU - Tribunal de Contas da União), në bashkëpunim me UNDP (United Nations Development Programme), financuar nga BNDES (O Banco Nacional do Desenvolvimento), në datat 30.09.2024 – 04.10.2024, në Rio de Janeiro, Brazil

Ky takim është një nismë globale, e filluar nga Federal Court of Accounts (TCU) – SAI Brazil, si drejtuese aktuale e INTOSAI (International Organisation of Supreme Audit Institutions), në vitin 2022. Kjo nismë ka gjashtë objektiva kryesore:



Platforma “ClimateScanner” është zhvilluar nga 18 SAI dhe organizata të ndryshme, me pjesëmarrjen e më shumë se 70 audituesve nga e gjithë bota. Në vitin 2024, SAI nga e gjithë bota janë ftuar për të përdorur këtë platformë, për të hedhur të gjitha të dhënat rajonale, me qëllimin që në Nëntor 2024, të kemi një pasqyrim global të situatës aktuale klimatike, si dhe masave të marra nga çdo shtet. Deri në Shtator, 2024, kjo platformë është përqafuar nga 143 shtete të ndryshme.

Kjo platformë është e ndërtuar mbi tre drejtime kryesore:

- 1. Qeverisja:** e cila përbëhet nga katër kategori (Institucionalizimi; Strategjia; Koordinimi; Llogaridhënia);
- 2. Politikat publike:** e cila përbëhet nga tre kategori (Angazhimi ndërkombëtar; Strategjitë e përgjithshme; Komponentët sektorial);
- 3. Financat:** e cila përbëhet nga dy kategori (Financat publike; Financat private)

Secila prej kategorive është e ndërtuar mbi komponentë dhe artikuj të ndryshëm, të cilat janë gjithëpërfshirëse dhe globale. Vlerësimi që audituesit i bëjnë secilit prej artikujve kryhet mbi matrica të paracaktuara nga platforma, duke e mbështetur vlerësimin në çdo rast me prova reale. Qëllimi i kësaj metodologjie vlerësimi është marrja e një pasqyre globale në lidhje me punën që secili rajon ose shtet është duke kryer në lidhje me ndryshimet klimatike, duke qenë se dhe vet këto ndryshime nuk janë rajonale, por më të gjera se kaq.

Në grupin e punës morrën pjesë 16 shtete të ndryshme të botës dhe 21 auditues, nga të gjashta rajonet (OLACEFS; EUROSAT; PASAI & CAROSAI; ARABOSAI & CREFIAF; ASOSAI; AFROSAT-E & CPLP). Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), u përfaqësua nga audituesi, z. Paolo Xhezo.

Gjatë këtij workshop-i, audituesit u trajnuan në njohjen e platformës, funksionimin e saj, metodologjinë e hedhjes së të dhënave, kriteret e vlerësimit për secilin artikull, si dhe përmbylljen e informacionit për secilin shtet.



Trajnimi zgjati nga data 30.09.2024 – 04.10.2024. Trajnuesit ishin pjesë të ekipit të SAI Brazil (TCU - Tribunal de Contas da União), si SAI drejtues aktual i INTOSAI dhe si nismëtarë të këtij projekti.

Faza e zbatimit të këtij projekti filloi në vitin 2024 në thirrjen globale të ClimateScanner në mars në selinë e Kombeve të Bashkuara (OKB) në Nju Jork, kur SAI nga e gjithë bota u ftuan të aplikonin platformën në vendet e tyre. Gjithashtu, gjatë gjithë vitit, SAI-t kanë marrë trajnime për t'u mundësuar atyre të kryejnë vlerësimet.